




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranimi / Dorëzimi / Prilazja / Prilazje / Reception / Delivery	29.04	1	viti / god / year
Organ / Organiza / Organ / Organizacija / Org / Unit	In Pro / In Pro / In Pro / In Pro	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKD/SHCK	2079/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.246/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca- kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi- Bajraktari anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2904/2019 të datës 26.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A. nr.578/2019 të datës 25.09.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Naser Hajrizi", nr.24, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.04.2021, mori këtë;

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.578/2019 e datës 25.09.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 03-1792/2, i datës 28.08.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Drejtësisë.

A r s y e t i m

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, me datë 11.07.2019 ka shpallur konkurs të brendshëm për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi mirëpo i njëjti nuk është përfshi në listën e ngushtë nga Komisioni Përzgjedhës.

Ankuesi i pakënaqur me mos përfshirjen e tij në listën e ngushtë, me datë 30.07.2019, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Drejtësisë. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 28.08.2019, përmes Vendimit me numër protokolli 03-1792/2 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.



Kundër Vendimit me numër protokolli 03-1792/2 të datës 28.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesi, me datë 25.09.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4520/2019 të regjistruar me numër A.nr.578/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se procedura e rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil. Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi të njëjtën kohë ka hapur edhe konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 26.03.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.796/2019, përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 25.09.2019 të parashtruar nga ankuesit

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4520/2019 të regjistruar me numër A.nr.578/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 03.09.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin e datës 03.09.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 28.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin e datës 26.08.2019; Aktgjykimin e datës 02.06.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Ankesën e datës 30.07.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Konkursin e datës 11.07.2019; Kërkesën për punësim të A. N- D, me shkresat e bashkangjitura; Vërtetimin e datës 18.07.2019; Vendimin e datës 15.12.2017; Akt Emërimit e datës 09.11.2017; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë; Diplomën e datës 28.06.2012; Kërkesën për punësim të ankuesit, me shkresat e bashkangjitura; Akt Emërimit e datës 01.08.2012; Vërtetimin e datës 12.07.2019; Diplomën e datës 08.09.2001; Diplomë e datës 23.06.2017; Njoftimin e datës 06.08.2019 për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm; Testin me shkrim; E-mailin e datës 31.06.2019; Renditjen përfundimtare të kandidateve; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Vlerësimin individual të kandidateve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohje e ndonjë gjuhe të huaj; Vendimin e datës 23.07.2019 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Listën e ngushtë të datës 23.07.2019; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Njoftimin e datës 05.11.2019 të Këshillit; Përgjigje në ankese me numër protokolli 4680/2019 të datës 07.10.2019, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e pa bazuar sepse:**

Ankuesi pretendon se procedura e rekrutimit nuk është zhvilluar sipas legjislacionit në fuqi, sepse i njëjti nuk është përfshirë në listën e ngushtë edhe pse i ka plotësuar kushtet e konkursit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, ka analizuar konkursin e shpallur me datë 11.07.2019 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se kriteret e konkursit për këtë pozitë të punës kanë qenë:

- *Diplomë Universitare në drejtimin Juridik, Administratë Publike, Ekonomik;*
- *Pesë (5) vite përvojë pune profesionale.*

Përkitazi me këtë, Kolegji ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe duke u bazuar në diplomën Nr.4906 të lëshuar me datë 14.09.2017 nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", ka konstatuar se ankuesi ka përfunduar Fakultetin Juridik me datë 23.06.2017, dhe si rrjedhojë i njëjti nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës profesionale, pesë (5) vjeçare, siç kërkohet në konkurs, sepse përvojë profesionale njihet përvoja e fituar pas diplomimit në njërin prej fushave respektive të përcaktuara në konkurs (*Juridik, Administratë Publike, Ekonomik*). Njohja e përvojës së punës profesionale vetëm pas diplomimit në fushën përkatëse është konfirmuar edhe me Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.77/2019 të datës 10.06.2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Andaj, bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë ka vepruar në pajtim me dispozitat e Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 28 ku përcaktohet se: *1. Anëtarët e KPSHC- së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim; 1.1. Arsimi dhe Kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës; 1.3 Shkathtësia dhe aftësitë' dhe 1.4 Elementet tjera të meritës.* Rrjedhimisht Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 11 paragrafin 1 ku përcaktohet se: *Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, po ashtu konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së drejtësisë, me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit dhe nxjerrjes së Vendimi 03-1792/2 të datës 28.08.2019 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi. Anëtari i Kolegjit i cili ka dhënë mendim mospajtues me këtë vendim, duhet të jap me shkrim mendimin mospajtues dhe i njëjti duhet t'i bashkëngjitet dosjes së lëndës.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative , brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.246/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Drejtësisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së

